

**DOKUMENTET PËR APLIKIM**

- a) kërkesë e përfaqësuesit ligjor, ku të jepen, të paktën, të dhëna për emrin dhe rezidencën e shoqërisë dhe të vlerësuesit/eve të shoqërisë që largohen apo shtohen;
- b) ekstraktin e regjistrit tregtar për të dhënat e subjektit (të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit, jo më vonë se 1 muaj nga aplikimi);
- c) kontrata e punës, e lidhur para noterit, ndërmjet përfaqësuesit ligjor të shoqërisë dhe vlerësuesit/sve të rinj që punësohen pranë saj;
- ç) vetëdeklarim i vlerësuesit/ve të rinj që punësohen, ku ata të deklarojnë se njohin dhe angazhohen të zbatojnë kushtet, rregullat dhe standardet e vendosura nga dispozitat në fuqi për ushtrimin e profesionit në fushën e vlerësimit të pasurive të paluajtshme dhe, në mungesë të tyre, t'u referohet standardeve evropiane të vlerësimit. Gjithashtu, të deklarojnë se nuk janë të dënuar nga organet e gjyqësorit, në lidhje me ushtrimin e profesionit të vlerësimit.

+ pagesa e tarifës

Për rastet kur aplikohet njëkohësisht edhe për pajisjen me licencë të vlerësuesve që shtohen të shoqërisë, vlerësuesi/t aplikojnë më vete për pajisje me licencë individuale dhe ky fakt saktësohet në aplikimin e shoqërisë (në kërkesën respektive të saj).

**Dorëzimi, pranimi i aplikimit**

- 1. Kërkesa për licencë dhe dokumentet shoqëruese të saj, sipas kësaj rregulloreje, dërgohen nëpërmjet sistemit informatik të integruar për shërbimet e licencimit në fushën e vlerësimit të pasurive të paluajtshme, që funksionon pranë portalit unik të shërbimeve qeveritare e-Albania.
- 2. Dokumentet për licencë duhet të jenë:
  - a) origjinale ose fotokopje të noterizuara;
  - b) në gjuhën shqipe ose të përkthyer në gjuhën shqipe nga përkthyes të licencuar;
  - c) për rastet e dokumenteve të huaja, kopje të vërtetuara nga një autoritet publik i juridiksionit të huaj (zyrtar/noter). Është detyrim të vërtetohet ekzistenca e tyre si zyrtarë apo noterë, nëpërmjet legalizimit apo apostilimit, sipas ligjeve në fuqi dhe marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë.
- 3. Pagesa e tarifës për përfitim të licencës kryhet ose nëpërmjet sistemit informatik të integruar për shërbimet e licencimit në fushën e vlerësimit të pasurive të paluajtshme, që funksionon pranë portalit unik të shërbimeve qeveritare e-Albania, ose pranë çdo banke të nivelit të dytë, nëpërmjet formularit të faturës për arkëtim, i cili shkarkohet nga portali ose mund të disponohet pranë sekretariatit teknik, në Ministrinë së Zhvillimit Urban.

**Të drejtat dhe Kushtet paraprake**

- 1. Shoqëria përfiton të njëjtën fushë/a veprimtari vlerësimi me atë/ato që ka apo përfiton vlerësuesi/t e shoqërisë.
- 2. Individit, vlerësuesi i shoqërisë dhe shoqëria, në rastin e plotësimit të kriterëve respektive, mund të përfitojnë licencë dhe të ushtrojnë veprimtari vlerësimi në një apo më shumë nga fushat e mësipërme.
- 3. Shoqëria përfiton licencë kur ka, të paktën, një vlerësues të licencuar të shkallës së parë ose që përfiton licencë të shkallës së parë njëkohësisht, gjithashtu, edhe mbi bazën e kushteve e kriterëve të përcaktuar në këtë rregullore.
- 4. Shoqëria dhe vlerësuesit e shoqërisë, që kërkon të licencohet, duhet të plotësojë kushtin që të mos jetë i dënuar nga organet gjyqësore për çështje që kanë lidhje me ushtrimin e aktivitetit profesional si vlerësues dhe të mos jetë në periudhën e ekzekutimit të një mase administrative të mëparshme, kundrejt licencës profesionale për vlerësim.
- 5. Vlerësuesi i shoqërisë, që kërkon të licencohet, duhet të njohë dhe të angazhohet të zbatojë kushtet, rregullat dhe standardet e vendosura nga dispozitat në fuqi për ushtrimin e këtij profesioni dhe, në mungesë të tyre, t'u referohet standardeve evropiane të vlerësimit.
- 6. Shoqëria, që kërkon të licencohet, duhet të ketë shlyer të gjitha detyrimet tatimore.
- 7. Shoqëria duhet të ketë statusin "aktiv" të ushtrimit të veprimtarisë në QKB dhe të mos jenë në proces falimentimi dhe/ose likuidimi.

**Afate dhe kufizime**

- 1. Licenca për shoqëritë jepet me afat, aq sa afati i kontratës që ka shoqëria me vlerësuesin e kontraktuar (ajo me afatin më të shkurtër, për rastet kur ka më shumë se një vlerësues me kontratë), por jo më shumë se 5 vjet.
- 2. Vlerësuesi i pasurive të paluajtshme, i licencuar, nuk mund të regjistrohet si vlerësues në më shumë se një shoqëri të licencuar për vlerësim të pasurive të paluajtshme